

RAPORTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË MAQEDONINË E VERIUT PËR VITIN 2018

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Republika e Maqedonisë së Veriut është demokraci parlamentare. Presidenti i zgjedhur nga qytetarët është udhëheqës i shtetit dhe komandant suprem i forcave të armatosura. Parlamenti njëdhomësh ushtron pushtetin ligjvënës. Zgjedhjet e fundit parlamentare u mbajtën në vitin 2016, ndërsa ato presidenciale në vitin 2014. Në raportin përfundimtar për zgjedhjet parlamentare, zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/ODIHR) ka deklaruar se zgjedhjet kanë qenë transparente, janë administruar mirë dhe në mënyrën e duhur, por që janë mbajtur në “rrethana të karakterizuara nga mungesa e besimit publik në institucione dhe te establishmenti politik” ndërsa nuk kanë përmbushur disa detyrime të rëndësishme të OSBE-së për një proces zgjedhor demokratik. Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-së mbi zgjedhjet presidenciale të vitit 2014 vuri në dukje se zgjedhjet respektuan liritë themelore të qytetarëve, por se nuk kishte ndarje të mjaftueshme midis veprimtarisë partiake dhe shtetërore.

Autoritetet civile kanë ruajtur kontrollin efektiv mbi forcat e sigurisë.

Çështjet e të drejtave të njeriut kanë përfshirë edhe korrupsion të nivelit të lartë.

Qeveria gjithashtu bëri hapa për të hetuar, ndjekur dhe dënuar zyrtarët që kanë bërë shpërdorime.

Pjesa 1. Respektimi i integritetit të personit, duke e përfshirë edhe lirinë nga:

a. Privimi arbitrar nga jeta ose vrasje të tjera të paligjshme ose për motive politike

Nuk ka pasur raporte që qeveria ose përfaqësuesit e saj të kenë kryer vrasje arbitrare ose të paligjshme.

b. Zhdukje

Nuk ka pasur raporte zhdukjesh, nga ose në emër të autoriteteve qeveritare.

c. Tortura dhe trajtimet ose ndëshkimet tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë këto praktika, por ka pasur disa raporte sipas të cilave policia ka abuzuar me të ndaluarit dhe të burgosurit dhe ka ushtruar forcë të tepërt. Qeveria ka vepruar për të hetuar dhe për të ndjekur pretendime legjitime. Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka raportuar se gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, ka vepruar në lidhje me 23 ankesa për ushtrim të forcës së tepërt nga efektivi policorë. Shtatë nga këto ankesa janë shpallur të pabaza, ndërsa janë pranuar dy ankesa. Në një rast, kundër një efektivit policie janë ngritur padi penale për përdorim të tepruar të forcës dhe janë ndërmarrë masa disiplinore për largimin e individit nga pozita deri në përfundimin e procedurës disiplinore. Procedura disiplinore ka qenë në vazhdim e sipër në fund të vitit. Në një rast tjetër, Ministria e Brendshme ka njoftuar Prokurorinë Publike dhe ka nisur procedurat disiplinore kundër katër efektivëve të policisë. Ministria e Brendshme ka deklaruar se nuk ka pasur prova për 14 ankesat e tjera. Në të njëjtën periudhë, SSP ka pranuar katër ankesa për përdorimin e forcës së tepruar kundër personave të marra në pyetje dhe në paraburgim. Hetimet e SSP kanë rezultuar me padi penale kundër një efektivit policie për trajtim të papërshtatshëm. SSP ka konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme për të vazhduar me tre rastet e tjera. Ka ndërmarrë masa disiplinore kundër dy efektivëve për këto vepra.

SSP ka vepruar në lidhje me një ankesë të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut për përdorimin e tepërt të kimikateve dhe forcës fizike dhe ndalimin e paligjshëm dhe heqjen e lirisë së një gazetari gjatë një proteste publike të 17 qershorit para parlamentit. Hetimet kishin treguar se efektivi e policisë kishin ndjekur procedurat e Ministrisë së Brendshme. Gazetari u arrestua

me sa duket sepse nuk pranoi të identifikohet. Hetimi ka konstatuar se nuk është përdorur forcë e tepruar në këtë rast.

Kushtet në burgje dhe qendrat e paraburgimit

Burgjet dhe qendrat e paraburgimit në vend nuk i kanë përmbushur standardet ndërkombëtare dhe në disa raste, sipas Raportit të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT) të Këshillit të Evropës të vitit 2017, i bazuar në vizitën e vitit 2016, kushtet mund të përshkruhen si mizore, çnjerëzore dhe degraduese. Korrupsioni, keqtrajtimi nga rojet e burgut, dhuna midis të burgosurve, kushtet e pasigurta dhe johigjienike, stafi i pamjaftueshëm dhe trajnimi i pamjaftueshëm i rojeve dhe personelit mbeten probleme serioze, veçanërisht në burgun e Idrizovës, i cili përfshin më shumë se tre të pestat e popullsisë së burgut të vendit.

Kushtet fizike: Vendi ka 11 burgje dhe tre objekte korrektuese për të mitur; në shtatë burgje janë vendosur edhe të paraburgosur në pritje të gjyqimit.

Sistemi i burgjeve ka vazhduar të përballlet me mungesë fondesh, trajnim joadekuat të efektivëve dhe korrupsion. Disa të burgosur të liruar nga burgu rishtazi, nga rastet e profilit të lartë kanë pretenduar se ishin keqtrajtuar ndërsa kanë qëndruar në burg. Më 17 prill, Komisioni Evropian (KE) lëshoi raportin e vitit 2018 për Maqedoninë e Veriut, i cili vuri në dukje se numri i ulët i ankesave lidhur me keqtrajtimin, të pranuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, nuk e ka paraqitur gjendjen e vërtetë si dhe ka treguar se mungon besimi në procedurat e ankimit. Përveç kësaj, ajo ka quajtur situatën në sistemin e burgjeve "kritike" për shkak të mungesës së mjeteve financiare, mungesës së stafit, keqmenaxhimit dhe mbipullimit.

Sipas Avokatit të Popullit, mbipopullimi kishte rënë për shkak të përmirësimeve në burgun e Idrizovës dhe një ligj amnistie të zbatuar në janar që ka zbutur mbipopullimin duke liruar 800 të burgosur me dënime prej më pak se gjashtë muajsh. Me amnistinë është vendosur gjithashtu një reduktim i dënimit prej 30 përqind për 3,000 të burgosur të tjerë. Ligji nuk ka përfshirë personat e dënuar për krime të rënda, si vrasje, përdhunim, krime seksuale ndaj fëmijëve, ose terrorizëm. Që nga 19 shtatori, Avokati i Popullit besonte se kishte ende nevojë për përmirësime të dukshme të kushteve në burgje.

Avokati i Popullit harton raport vjetor i cili përfshin të dhëna mbi kushtet në burgje. Raporti më i fundit është lëshuar më 29 mars ku thuhet: "mbipopullimi dhe kushtet e këqija në institucionet ndëshkuese korrektuese mbetet një problem serioz. Me këtë është shkelur dinjiteti njerëzor i personave të privuar nga liria. Sistemi i kujdesit shëndetësor të burgjeve ka mbetur edhe më tej jofunksional dhe kjo shkon në dëm të personave të dënuar dhe të personave në paraburgim të cilët madje nuk kanë pasur as sigurim shëndetësor. Kjo situatë ka ndikuar mbi pakënaqësinë e personave të dënuar dhe të paraburgosur, por gjithashtu ka rritur dyshimet lidhur me trajtimin efektiv dhe shërbimet e tjera shëndetësore në institucionet ndëshkuese. Sektori i sigurisë, Departamenti për ri-socializim, si dhe shërbimi shëndetësor nuk kanë qenë të pajisur as me personel dhe as me profesionalizëm".

Në vlerësimin e vitit 2016, KPT-ja ka vënë re se anekset sanitare ishin në një "gjendje të tmerrshme (të ndyra, me erë të keqe, të dëmtuara dhe me rrjedhje), shumë nga dushet nuk funksiononin dhe nuk kishte pothuajse fare furnizim me ujë të ngrohtë". KPT ka vërejtur se ngrohja ka punuar vetëm disa orë në ditë dhe se kujdesi shëndetësor në burgjet e Idrizovës dhe Shkupit ka qenë i pamjaftueshëm, ku shumë të burgosur kanë vuajtur nga kafshimet e insekteve dhe infeksionet si zgjebja.

Personeli i pamjaftueshëm dhe trajtimi joadekuat i rojeve të burgut dhe personelit kanë mbetur probleme në të gjitha objektet.

Administrimi: Avokati i Popullit ka konstatuar se hetimet e autoriteteve korrektuese mbi pretendimet për keqtrajtim dhe abuzimin e të burgosurve kanë qenë përgjithësisht të

paefektshme.

Numri i personave në burgje pa dokumente identifikimi ka shënuar rënie.

Monitorimi i pavarur: Ligji mundëson që personat në paraburgim të vizitohen nga mjekët, përfaqësuesit diplomatikë dhe përfaqësuesit të KPT-së dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, me leje paraprake nga gjykatësi hetues. Qeveria paraprakisht u ka lejuar organizatave të pavarura humanitare, siç është Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vend, qasjen deri të burgosurit e dënuar me kërkesë të të burgosurve, por në nëntor Komiteti kishte firmosur memorandum për mirëkuptim me Qeverinë për të siguruar qasje të pakufizuar.

Avokati i Popullit i ka vizituar rregullisht (një herë në muaj) burgjet në vend dhe i ka hetuar pretendimet e besueshme për kushte problematike.

Përmirësime: Ministria e Drejtësisë ka deklaruar se faza e parë e përmirësimeve në burgun e Idrizovës ka përfunduar në gusht, duke rritur kapacitetin e burgut për 546 persona të tjerë, në gjithsej 1,346. Përmirësimet kanë përfshirë ndërtimin e tri godinave, një me kapacitet prej 294 të burgosur dhe dy objekte për 252 të burgosur në pjesën gjysmë të hapur. Janë blerë mobilje, kuzhina çaji, lavanderi, palestër, si dhe dyshekë, çarçaf dhe pajisje sigurie.

a. Arrestimi ose paraburgimi arbitrar

Ligji ndalon arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikon të drejtën e çdo personi për të kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij në gjykatë, ndërsa qeveria përgjithësisht i ka respektuar këto kërkesa.

Roli i policisë dhe aparatit të sigurisë

Ushtria është përgjegjëse për sigurinë e jashtme, ndërsa Presidenti është komandanti suprem i Armatës. Policia kombëtare ruan sigurinë e brendshme, duke përfshirë edhe migracionin dhe mbrojtjen e kufijve, si dhe i raporton Ministrisë së Punëve të Brendshme. Përkundër pengesave nga raste të korrupsionit dhe presionit politik, Ministria e Brendshme ka bërë disa përparime në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së saj.

Autoritetet civile kanë kontrollin efektiv mbi ushtrinë dhe Ministrinë e Brendshme, kurse qeveria ka mekanizma efektivë për të hetuar dhe dënuar abuzimin. Megjithatë, Avokati i Popullit beson se mosdëshkimi i efektivëve të policisë mbetet problem.

Deri më 28 gusht, në zyrën e Avokatit të Popullit janë dorëzuar 11 ankesa kundër efektivëve të policisë për përdorim të paligjshëm ose të tepërt të forcës, krahasuar me nëntë ankesa në vitin 2017. Në një rast, zyra nuk ka mundur të konstatojë faktet, duke pasur parasysh se kishte kaluar shumë kohë nga incidenti deri te denoncimi. Në rastin e dytë, zyra ka konstatuar se përdorimi i forcës nuk ka qenë në përputhje me rregulloren e institucionit.

Deri më 28 gusht, zyra e Avokatit të Popullit ka raportuar se kishte pranuar gjithsej 163 ankesa nga të burgosurit. Në tri ankesa, të burgosurit kanë shprehur pretendimet për torturë nga rojet e burgut. Një hetim ishte i pazgjidhur; dy të tjerat nuk kanë dhënë rezultate konkrete bazuar në dëshmitë që i ka pasur Avokati i Popullit.

Deri më 28 gusht, Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve ka marrë dy njoftime për përdorimin force ndaj të burgosurve nga ana e policisë së burgut, kundrejt 14 sosh në vitin 2017.

Më 12 prill, parlamenti solli tre ligje: Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, Ligjin për themelimin e Agjencisë Teknike Operative (ATO) si organ përgjegjës për përgjimet e ligjshme në vend dhe Ligjin për Përgjimin e Komunikimeve. ATO pritet të jetë lehtësuesi teknik i operacioneve të përgjimit të ligjshëm të komunikimeve, që do veprojnë me buxhet të pavarur nga Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) e Ministrisë së Brendshme. ATO ka filluar me punë në nëntor.

Më 20 nëntor, Kabineti i Kryeministrit ka miratuar *Modelin e Propozuar dhe Planin e Zbatimit të Reformës së Sistemit të Sigurisë dhe Zbulimit*. Kabineti e ka ngarkuar Ministrinë e Brendshme, për koordinimin e zbatimit të reformës, në bashkëpunim me institucionet e interesuara.

Përveç hetimit të pretendimeve për keqtrajtim nga efektivët e policisë, Sektori për Standarde Profesionale (SSP) i Ministrisë së Brendshme ka zhvilluar të gjitha hetimet e brendshme mbi pretendimet për forma tjera të sjelljes së keqe të policëve. Sektori, gjatë hetimeve, ka të drejtën e shqiptimit të sanksioneve administrative, siç është suspendimi i përkohshëm nga puna. Sektori nuk mund të marrë masa disiplinore, të cilat kërkojnë një vendim nga një komision disiplinor dhe as të vendosë sanksione penale më të rënda, të cilat kërkojnë veprime gjyqësore.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve

Ligji parasheh që gjyqtari të lëshojë urdhër për arrestimin dhe ndalimin të të dyshuarve bazuar në prova, dhe policia në përgjithësi ka ndjekur këtë dispozitë. Ligji parasheh që personi i ndaluar të paraqitet para prokurorit në afat prej 24 orëve pas arrestimit. Gjyqtari i procedurës paragjyqësore, me kërkesë të prokurorit mund të urdhërojë ndalimin e të dyshuarit deri në 72 orë para daljes në gjyq. Në përgjithësi, policia u është përmbajtur këtyre procedurave. Autoritetet në përgjithësi kanë informuar të ndaluarit menjëherë për akuzat kundër tyre. Paraburgimi para ngritjes së padisë mund të zgjasë më së shumti 180 ditë. Pas ngritjes së padisë, periudha maksimale e paraburgimit është dy vite.

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit, SSP i Ministrisë së Brendshme ka pranuar katër ankesa për pretendime për përdorimin e tepruar të forcës gjatë marrjes në pyetje të të dyshuarve dhe personave në paraburgim. SSP ka ngritur padi penale kundër një efektiv policie për trajtim të papërshtatshëm policor dhe ka hedhur poshtë tre të tjera për shkak të mungesës së provave.

Ekziston sistemi i dorëzanisë. Ligji i lejon të pandehurit të komunikojë me një avokat të zgjedhur prej tyre, por autoritetet nuk kanë informuar gjithmonë të ndaluarit ashtu siç duhet për të drejtën e tyre dhe nuk kanë lejuar gjithmonë që të konsultohen me një avokat para paraqitjes në gjykatë. Të ndaluarit e varfër kanë të drejtë të kenë avokat në llogari të shtetit, dhe autoritetet në përgjithësi e kanë respektuar këtë kërkesë. Gjyqtarët zakonisht u kanë dhënë leje avokatëve për të vizituar klientët e tyre në paraburgim. Vendi nuk e ka praktikuar paraburgimin pa njoftim.

Paraburgimi: Në të shumtën e rasteve, gjykatat kanë respektuar ligjin për procedurat e paraburgimit. Gjatë vitit, numri i urdhrave të gjykatës për paraburgim ka rënë në mënyrë të konsiderueshme krahasuar me vitet e kaluara. Në shumicën e rasteve, Prokuroria Publike dhe Prokuroria Speciale kanë kërkuar, ndërsa gjykata ka vendosur masën e parandalimit, në vend të urdhrit për paraburgim të të dyshuarve dhe të pandehurve për të parandaluar rrezikun e ikjes së dëshmitarëve, manipulimit të provave dhe përsëritjen ose kryerjen e krimeve të reja.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon gjykata "autonome dhe të pavarura", të mbështetura nga Këshilli Gjyqësor i pavarur dhe autonom. Qeveria ka treguar respekt më të madh për pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit krahasuar me vitet e kaluara. Pavarësia e kufizuar gjyqësore, politizimi i organit mbikëqyrës gjyqësor dhe financimi i pamjaftueshëm i gjyqësorit, megjithatë, kanë vazhduar të pengojnë punën dhe efektivitetin e gjyqësorit.

Sipas raportit të KE-së të 17 prillit, gjyqësori në vend ka arritur përparim të caktuar në rritjen e pavarësisë. Shteti ka sjellë një strategji të re të besueshme për reformën gjyqësore dhe pjesët kryesore të legjisllacionit janë ndryshuar në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe "Prioritetet e Reformave Urgjente" të BE-së. Prokuroria Speciale është përballur me më pak pengesa nga gjykatat. Raporti i KE-së gjithashtu ka arritur në përfundimin se nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të zbatuar rekomandimet e kryesore dhe për të siguruar që gjyqësori të mund të funksionojë pa ndikim të pajustificuar.

Më 28 mars, kryeministri Zoran Zaev ka nisur një Këshill të ri për monitorimin e zbatimit të

reformës gjyqësore, që përbëhet prej ministrit të drejtësisë, kryeprokurorit publik, prokurorit special dhe gjyqtarëve të tjerë, zyrtarëve qeveritarë, avokatëve privatë dhe akademikëve. Qëllimi i Këshillit është të ndjek zbatimin e reformave gjyqësore në kuadër të planit qeveritar të reformave.

Sipas Raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, numri më i madh i parashtresave nga qytetarët (576 ose 17 për qind) kanë qenë në lidhje me gjyqësorin. Pothuajse gjysma e parashtresave kanë qenë në lidhje me të drejtat e qytetarëve në procedurat e përmbarimit. Mes janarit dhe gushtit, numri më i madh i parashtresave (432 ose 19 për qind) kanë qenë në lidhje me gjyqësorin. Raporti ka cekur se qytetarët janë ankuar në lidhje me gjykimet e gjata, paanshmërinë, drejtësinë selektive, dhe presionin e pajustificuar mbi gjyqtarët. Raporti thekson se vendimet gjyqësore nganjëherë janë vonuar në mënyrë të konsiderueshme për shkak të mangësisë administrative ose për shkak se gjyqtarët kanë tejkaluar afatet e përcaktuara me ligj për lëshimin e aktgjykimeve me shkrim.

Ndërsa ka pasur rregulla të rrepta që e rregullojnë shpërndarjen e lëndëve, të realizuara nëpërmjet një sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve, në shtator, Prokuroria Publike e Shkupit ka marrë në pyetje disa persona, pasi një auditim i vitit 2017 ka zbuluar se sistemi i caktimit të gjyqtarëve për të trajtuar raste specifike ishte manipuluar. Mediat kanë njoftuar se prokurorët kishin thirrur ish "gjykatësin kryesues" të Gjykatës Penale të Shkupit, Vlladimir Pançevski dhe të Gjykatës Supreme të Drejtësisë Jovo Vangelovski. Më 14 shtator, Zyra e Prokurorisë Speciale ka paraqitur një *Raport Special mbi Gjykatësit e Përfshirë në përgjimet e paligjshme të vitit 2008-2015*. Raporti thekson se prej vitit 2011 deri në vitin 2015, katër gjykatës janë përfshirë në "shkelje flagrante të integritetit, pavarësisë, kompetencës dhe shpërdorim të detyrës". Raporti përshkruan veprimet e pretenduara në vitin 2011 dhe 2012 nën qeverinë e mëparshme, në veçanti se Vangelovski ka lëshuar informata kyçe lidhur me rastet aktive me politikanët dhe kolegët nën presion gjatë gjykimeve. Përveç kësaj, ai ka deklaruar se ish kryetarja e Këshillit Gjyqësor Aleksandra Zafirovska ka konsultuar zyrtarë të lartë qeveritarë për zgjedhjen e gjyqtarëve politikisht besnikë ose "të favorshëm", se gjyqtarja penale Sofija Laliçiq ka ndjekur urdhra nga zyrtarë të lartë të DSK-së dhe ka shkelur rëndë kodin etik të gjyqtarëve dhe gjyqtarja administrative Svetllana Kostova ka punuar në të njëjtën kohë si gjyqtare dhe si staf i DSK-së.

Procedurat gjyqësore

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe gjyqësori në përgjithësi e ka zbatuar këtë të drejtë.

Ligji e parasheh prezumimin e pafajësisë, deri në momentin kur dëshmohet fajësia e të pandehurve. Të pandehurit kanë të drejtë të informohen menjëherë dhe hollësisht për akuzat (me interpretim falas sipas nevojës). Në përgjithësi, gjykimet kanë qenë të hapura për publikun. Raporti vjetor i Avokatit të Popullit i vitit 2017 ka vërejtur probleme të vazhdueshme lidhur me të drejtën për gjykim në një kohë të arsyeshme. Sipas raportit, rastet e zgjatura të gjykatave civile dhe administrative, si dhe praktikat e pamjaftueshme të zbatimit të ligjit, rezultuan në shkelje të të drejtave të qytetarëve. Në raste të profilit të lartë, ka qenë e zakonshme që avokatët e mbrojtjes të kërkonin një "shtyrje strategjike" të procedurave.

Për disa raste penale dhe civile, janë përdorur trupa gjyqësorë prej tre deri pesë persona, të udhëhequr nga një gjyqtar profesionist. Autoritetet nuk i kanë dhënë gjithmonë të pandehurit kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen. Në veçanti, të pandehurit e Prokurorisë Speciale (PSP) janë ankuar se gjykata nuk ka dhënë gjithmonë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen. Ndihma falas është ofruar për të siguruar përkthyes. Të pandehurit kanë pasur mundësinë të komunikojnë me një avokat të zgjedhur prej tyre ose ata më të varfrit kanë të drejtën për një avokat shpenzimet për të cilin paguhen nga shteti. Të pandehurit mund t'u bëjnë pyetje dëshmitarëve dhe të paraqesin prova në emër të vet. Autoritetet nuk mund të detyrojnë të pandehurit të dëshmojnë ose të pranojnë fajësinë. Si prokuroria ashtu dhe të pandehurit kanë të drejtën të ankimojnë aktgjykimet.

Më 22 gusht, Gjykata Penale e Shkupit ka nisur gjykimin e 33 personave të akuzuar për "rrezikimin terrorist të rendit kushtetues" për veprimet e tyre gjatë sulmeve të dhunshme në prill të vitit 2017 në parlament. Katër deputet, një anëtar i Partisë Socialiste dhe ish-ministër i Brendshëm, kanë qenë midis të akuzuarve, katër anëtarë të Partisë Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE). Në fjalën e saj hyrëse, prokuroria ka deklaruar se sulmet kriminale ishin të organizuara mirë dhe se njëri nga të pandehurit kishte pasur detyrën të vriste Zoran Zaevin, i cili u bë kryeministër një muaj pas sulmeve. Gjykata ka vazhduar në fund të vitit. Më 18 dhjetor, parlamenti ka miratuar një Ligj Amnistie për disa pjesëmarrës në sulmet, por jo për ata që kanë kryer dhunë, kanë bartur armë, ose kanë organizuar incidentin.

Më 16 nëntor, Gjykata Kushtetuese ka shpallur si jokushtetues një ligj të vitit 2015 mbi udhëzimet e dënimeve, që kishte për qëllim të adresonte mospërputhshmëritë midis dënimeve të shqiptuara nga gjykatat e ndryshme. Analistët juridik kishin shprehur shqetësimin se ligji seriozisht ka penguar lirinë e gjyqësorit për të vendosur dënime sipas fakteve në rastet e veçanta dhe u ka dhënë prokurorëve pushtet të madh për të ndikuar dënimet.

Më 11 janar, parlamenti ka shfuqizuar Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe ka ndryshuar Ligjin për Këshillin Gjyqësor për të rivendosur kompetencat e Këshillit Gjyqësor lidhur me disiplinën dhe shkarkimin e gjyqtarëve, në përputhje me mendimin e Komisionit të Venecias 2015. Më 2 maj, parlamenti ka ndryshuar Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin për Këshillin Gjyqësor për të futur baza më të ashpra disiplinore, për të kufizuar të drejtën e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor për të aplikuar për pozita më të larta gjyqësore gjatë shërbimit në Këshill dhe për të lejuar shkarkimin e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të akuzuar për vepër penale. Më 15 maj, Shoqata e Gjyqtarëve ka deklaruar se ndryshimet në Ligjet për Gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor nuk kishin arritur të përmbushnin pritjet e gjyqtarëve për reforma efektive, duke përfshirë përgjegjësinë disiplinore dhe bazat e shkarkimit. Bordi i shoqatës ka arritur në përfundimin se ndryshimet nuk kanë qenë në përputhje me *Strategjinë e Reformës Gjyqësore 2017-22* të qeverisë dhe i ka bërë thirrje qeverisë dhe opozitës të bënin ndryshime që do të siguronin pavarësinë e gjyqësorit.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Ka pasur një raportim për të burgosur politik. Partia opozitare VMRO-DPMNE ka pretenduar se akuzat e ngritura kundër 33 të pandehurve, duke përfshirë pesë deputetë, në rastin e dhunës në parlament në prill të vitit 2017, kanë qenë politikisht të motivuara dhe të fryra (shih Procedurat e Gjykimeve më lart). Nuk ka pasur prova se qeveria ka mohuar qasjen e këtyre të burgosurve në të drejtat e njeriut ose organizatat humanitare. Gjykimi ka vazhduar pas 21 nëntorit.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Qytetarët kanë pasur qasje në gjykata për ngritjen e procedurave me të cilat kërkohet dëmshpërblim për shkeljen e të drejtave të njeriut. Një person mund të iniciojë procedurë për të drejtat e njeriut në gjykatat civile, penale ose administrative, dhe në Gjykatën Kushtetuese, varësisht nga lloji i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe nga kryerësi i pretenduar. Individët mund të parashtrajnë edhe ankesa ndaj aktgjykimeve të pavolitshme. Ligji e parasheh të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe kjo është bazë ligjore për ngritjen e procedurave para Gjykatës Supreme për shtyrje të tepërta. Në përgjithësi, Qeveria i ka respektuar aktgjykimet civile të gjykatave vendase. Individët mund të ankohen për rastet që përfshijnë shkeljet e pretenduara të shtetit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), pasi të jenë shtetur të gjitha mundësitë e brendshme ligjore.

Kthimi i pronës

Qeveria ka ligje dhe mekanizma, ndërsa organizatat joqeveritare (OJQ) dhe grupet e avokimit raportojnë se qeveria ka bërë përparim të konsiderueshëm në zgjidhjen e kërkesave të kohës së Holokaustit për shtetasit e saj. Qeveria nuk ka ligje ose mekanizma në lidhje me zgjidhjen e pretendimeve të kohës së Holokaustit nga shtetasit e huaj. Kthimi i

pronës nga periudha e Holokaustit nuk është më një çështje domethënëse në vend, veçanërisht pas Ligjit të Denacionalizimit të vitit 2000 dhe marrëveshjes së kompensimit të vitit 2007.

Ligji për Denacionalizim i vitit 2000 i akordoi të drejtën e denacionalizimit të pasurisë së konfiskuar pas gushtit të vitit 1944 ish-pronarëve dhe pasardhësve të tyre, në përputhje me dispozitat lidhur me të drejtën e trashëgimit. Ai kërkon që aplikuesit të kenë shtetësinë në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit.

Marrëveshja e kompensimit për vitin 2007 ishte midis Qeverisë, Fondit të Holokaustit dhe Bashkësisë Hebraike mundësoi pagesën prej 21.1 milionë eurosh (24.2 milionë dollarë) midis qershorit 2009 dhe qershorit 2018. Një nga rezultatet kryesore të marrëveshjes ishte ndërtimi i Qendrës Përkujtimore të Holokaustit të Hebrenjve nga Maqedonia, e cila zyrtarisht u hap në vitin 2011. Në qershor, qeveria ka paguar këstin e fundit prej 5.6 milion euro (6.4 milionë dollarë) në fond, duke përfunduar procesin e denacionalizimit të pronave hebraike.

Grupet e avokimit kanë raportuar se disa shtetas të huaj, që nuk mbulohen nga ligji i vitit 2000, ende kërkonin kthimin. Qytetarët e huaj mund të aplikojnë për kthim në procedurat civile. Vendi është palë në Deklaratën Terezin të vitit 2009.

f. Ndërhyrje arbitrare në privatësi, familje, shtëpi ose korrespondencë

Ligji i ndalon këto veprime, dhe nuk ka pasur raporte që tregojnë se Qeveria nuk i ka respektuar këto ndalime gjatë vitit. Më 12 prill, parlamenti ka themeluar Agjencinë Teknike Operacionale (ATO) e ngarkuar për përgjimet e ligjshme në vend (shih seksionin 1.d., Roli i policisë dhe Aparati i sigurisë).

Gjatë vitit qeveria ka vazhduar të merret me pasojat e zbulimit të përgjimeve të paligjshme, për të cilat pretendohet se janë kryer vite të tëra brenda ambienteve të DSK-së gjatë qeverisë të mëparshme nën drejtimin e VMRO-DPMNE-së. Kjo për herë të parë u raportua nga partia e LSDM-së në vitin 2015, asokohe parti opozitare.

Në fund të vitit 2016, Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, agjencia përgjegjëse për mbikëqyrjen e trajtimit të të dhënave personale nga Qeveria, ka kryer katër inspektime të DSK-së dhe ka filluar një inspektim kontrolli në korrik të vitit 2017 për të matur zbatimin e 11 rekomandimeve të bëra gjatë inspektimeve të vitit 2016. Një raport i pajtueshmërisë i publikuar nga Drejtoria në nëntor të vitit 2017 thotë se Ministria e Punëve të Brendshme i ka zbatuar në tërësi rekomandimet.

Në vitin 2016, parlamenti ka ndryshuar Ligjin për mbrojtjen e privatësisë për të ndaluar posedimin, përpunimin dhe publikimin e çdo përmbajtje, duke përfshirë bisedat e përgjuara, me ç'rast shkelet e drejta e privatësisë në lidhje me jetën personale apo familjare. Amendamentet, që hynë në fuqi në korrik, gjithashtu e ndalojnë përdorimin e materialeve të tilla në fushatat zgjedhore apo për qëllime të tjera politike.

Pjesa 2. Respektimi i lirive civile, ku përfshihet:

a. Liria e shprehjes, duke përfshirë edhe shtypin

Kushtetuta e garanton lirinë e fjalës, duke përfshirë këtu edhe lirinë e shtypit. Qeveria ka shënuar përparim në respektimin e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes, por problemet siç janë pavarësia e dobët e medias, dhuna dhe frikësimi i gazetarëve, kanë mbetur edhe më tej.

Raporti i KE-së i 17 prillit për vendin thekson se "klime e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes është përmirësuar, me një debat më të hapur politik dhe me raportimin e mediave kritike" dhe se ka pasur një "ulje të presionit ndaj gazetarëve". Raporti Freedom House *Vendet në tranzicion i vitit 2018*, i lëshuar më 11 prill, e ka karakterizuar peizazhin medial "pak të përmirësuar, që

reflekton zhvillime pozitive në lidhje me besueshmërinë e raportimit si rezultat i ndryshimit të pushtetit në nivel qendror". Raporti ka vënë në dukje se mediat mbetën kryesisht të polarizuara përgjatë linjave politike, etnike dhe gjuhësore dhe se "janë ende larg veprimit të pavarur nga ndikimi politik".

Në një letër të hapur të datës 27 korrik, krerët e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve të Mediave (SPGPM) dhe Këshilli i Etikës së Medias kanë kritikuar ndryshimet në kodin zgjedhor të 25 korrikut, duke pretenduar se ato kanë lejuar që reklamimi politik të paguhet nga buxheti i shtetit. Në letër thuhet se me ndryshimet është shpërfillur kundërshtimi i medias të pavarur për përdorimin e parave të taksapaguesve për reklamim politik në median komerciale, një praktikë që supozohej të kishte marrë fund në vitin 2017. Agjencia për shërbime mediatike audio-vizuale (ASHMAV) dhe platforma e Këshillit të Evropës kanë lëshuar deklaratat duke i përcjellë këto shqetësime.

Në gusht është krijuar Këshilli Gjyqësor-Mediatik për të përmirësuar bashkëpunimin midis gjyqësorit dhe gazetarëve përmes rritjes së transparencës së gjykatave dhe raportimit objektiv.

Liria e shprehjes: Ligji e ndalon gjuhën e cila nxit urrejtje nacionale, fetare ose etnike dhe parasheh sanksione për personat që i shkelin këto ligje. Individët mund ta kritikojnë Qeverinë publikisht ose privatisht.

Liria e mediave dhe e shtypit: Ndërsa media dhe raportimi kanë mbetur thellësisht të ndarë përgjatë linjave politike, numri i mediave të pavarura që në mënyrë aktive kanë shprehur hapur vështrime të ndryshme, ka shënuar rritje. Ligjet që ndalojnë gjuhën e cila nxit urrejtjen nacionale, fetare dhe etnike mbulojnë edhe shtypin dhe mediat elektronike, publikimin e librave, si dhe gazetat dhe revistat në internet.

Një raport periodik mbi statusin e reformave të medias, i përgatitur nga Fondacioni Metamorfozis, Agora dhe Platforma për Gazetari dhe Analizat Investiguese (PINA) i botuar më 6 mars, ka konstatuar se reformat e medias kanë avancuar me ritëm dhe cilësi të ndryshme dhe shumica janë zbatuar vetëm pjesërisht. Në raportin e 17 prillit, KE ka deklaruar se: "Qeveria e re i dha fund reklamave qeveritare në formën e reklamave komerciale të transmetuesit komercial (përveç në mediat sociale dhe në nivel lokal) në gusht të vitit 2017, pas moratoriumit që është vendosur që nga viti 2015. Për të arritur një nga "Prioritetet Urgjente të Reformave", qeveria e re gjithashtu ka bërë publike shifrat për shpenzimet e reklamave qeveritare nga 2008-2015, megjithëse disa të dhëna kanë munguar. Shkalla e reklamimit të qeverisë, që ka qenë një mjet për të ushtruar ndikim mbi transmetuesit dhe me të cilin sistemi i mëparshëm kishte shtrembëruar tregun, u reflektua në reagimin e tregut ndaj humbjes së këtij burimi të të ardhurave, i cili kishte pasur tashmë një ndikim financiar në sektorin e transmetimit dhe kishte bërë që mediat private të masin shikueshmërinë për shkak të nevojës për të konkurruar për audiencë dhe reklama".

Raporti i KE ka vënë në dukje gjithashtu "përmirësimin e cilësisë së raportimit nga disa stacione televizive private; megjithatë, standardet e ulëta profesionale kanë vazhduar në disa media, duke cënuar raportimin objektiv. Monitorimi nga këshilli i etikës së medias tregon se mbetet ende për të bërë për të përmirësuar respektimin e standardeve etike. Raportimi i investigues mbetet i kufizuar."

Më 25 shtator, ASHMAV ka lëshuar raportin e saj të parë mbi mbulimin mediatik të referendumit të vitit 2018 (për ndryshimin e emrit të vendit), duke pohuar se qytetarët nuk kanë marrë një mbulim të balancuar të të gjitha këndvështrimeve të ndryshme mbi referendumin. Përveç kësaj agjencia ka ngritur padi për kundërvajtje kundër ITV për tejkalimin e maksimumit të lejuar prej 4.5 minuta në orë të reklamave për fushatën "Për" të referendumit dhe kundër TV Sonce për tejkalimin e 4.5 minutave të lejuara në orë të reklamimit për përkrahësit e fushatës "Bojkoto". ASHMAV kishte thënë se kishte paralajmëruar disa transmetues të tjerë për shkelje të afateve kohore të referendumit, duke thënë se nëse shërbimet nuk e ndreqin problemin ata gjithashtu do të paditeshin për kundërvajtje. OSBE / ODIHR ka raportuar se "mediat

përgjithësisht kanë ofruar mbulim të drejtë" dhe se fushata "Kundër" ose "Bojkoto" kanë munguar në mediat tradicionale, duke penguar mediat të sigurojnë mbulim të barabartë. Përveç kësaj, OSBE / ODIHR-i ka vënë në dukje se mediat nuk kanë respektuar gjithmonë rregulloret e ASHMAV për ndarjen e barabartë të kohës së transmetimit të financuar nga buxheti duke i dhënë pjesën më të madhe fushatës "për".

Dhuna dhe ngacmimi: Ka pasur disa raste të kërcënimeve, dhunës dhe ngacmimeve të pretenduara të policisë ndaj gazetarëve gjatë vitit.

Më 8 mars, presidenti i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (AJM) Naser Selmani është ankuar publikisht se ai dhe familja e tij ishin kërcënuar nga një person i lidhur me Partinë e Bashkimit Demokratik për Integrim. Më 19 mars, Prokuroria Themelore e Shkupit ka hapur një hetim paraprak.

Më 8 shtator, Gjykata Penale e Shkupit ka dënuar Matija Kanikov me gjashtë muaj burg për sulme ndaj një gazetari të AION gjatë protestave të vitit 2017 "*Së bashku për Maqedoninë*". Shoqatat e gazetarëve ka përshëndetur vendimin gjyqësor sepse me atë dërgohej një mesazhi i qartë se sistemi nuk do të toleronte dhunën kundër gazetarëve, duke përmirësuar kështu sigurinë e gazetarëve.

Në një deklaratë pas një takimi me përfaqësuesin e medias të OSBE-së, Harlem Desir më 17 shtator, presidenti i SHGM-së Naser Selmani, ka theksuar se siguria e gazetarëve është përmirësuar pasi veprimet e dhunës dhe ngacmimet ndaj gazetarëve janë "reduktuar në mënyrë drastike". "Për herë të parë", një gjykatë në vitin 2017 kishte dënuar me burg një person për sulm fizik ndaj një gazetari. Selmani ka shtuar se megjithatë, në vend mbetet problemi i ambientit të mosndëshkimit.

Më 29 maj, Ministri i Brendshëm Oliver Spasovski ka thënë në një konferencë për shtyp se sipas një raportit të përgatitur nga Ministria, autoritetet kishin ngritur 12 padi kundër individëve për sulme kundër gazetarëve prej muajit qershor të vitit 2017 deri më 29 maj. "Jemi marrë me të gjitha rastet. Kemi ngritur padi penale kundër dy individëve për dhunë dhe kërcënime ndaj sigurisë, tri padi për kundërvajtje kundër gjashtë personave. Në një rast, ne kemi njoftuar zyrën përkatëse të prokurorisë për kërcënime ndaj sigurisë; në një rast, kemi vendosur që të ngrihet padi civile; dhe vetëm një rast ka mbetur i pazgjidhur," ka thënë ai.

Censura ose kufizimi i përmbajtjeve: Ka pasur disa raportime sipas të cilave Qeveria ka detyruar gazetarët të vetë-censurohen. Në raportin e saj të 17 prillit për vendin, KE ka vënë në dukje se "Nuk kishte përmirësim në mbrojtjen e sindikatës apo kushteve të punës së gazetarëve. Si rezultat i kësaj, gazetarët kanë vazhduar të praktikojnë vetëcensurimin."

SHGM ka raportuar se, që nga 27 gushti, dy gazetarë televizivë janë ankuar për censurë. Snezhana Lupevska, autorja e programit investigues Kod, ka pretenduar se drejtuesit e TV Telma kanë censuruar emisionin e saj. Si përgjigje ndaj reagimeve publike, Telma TV ka transmetuar programin origjinal pa redaktime. Kristina Atovska, një ish-punonjëse e 24 Vesti TV, është ankuar se dy redaktorë rregullisht kishin censuruar kontributet e saja.

Ligjet për shpifje/Siguria nacionale: Personat e shpallur fajtorë për trillime, shpifje dhe gjuhë të ligë janë dënuar sipas gjobave të përcaktuara për shkaktimin e dëmit jomaterial.

Sipas SHGM, deri më 23 nëntor, ka pasur rreth 39 raste për shpifje që përfshijnë gazetarët, redaktorët, dhe/ose menaxherët dhe pronarët e medias, në pritje të gjyqimit. Informacioni në lidhje me rastet në pritje nga vitet e kaluara nuk ishte i plotë. KE ka vënë re se numri I rasteve të shpifjes ka shënuar rënie.

Liria e internetit

Qeveria nuk ka kufizuar ose penguar qasjen në internet ose censuruar përmbajtjet në internet. Nuk ka pasur raporte për vëzhgim qeveritar të komunikimeve private online pa autorizim

përkatës. Enti Shtetëror i Statistikës ka vlerësuar se 75 për qind e popullsisë ka përdorur internetin në tremujorin e parë të vitit, në krahasim me 69 për qind në vitin 2016.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Nuk ka pasur kufizime qeveritare për lirinë akademike apo ngjarjet kulturore.

b. Liria e tubimit dhe shoqërimit paqësor

Ligji e parasheh lirinë e tubimit dhe shoqërimit paqësor dhe Qeveria në përgjithësi i ka respektuar.

c. Liria e besimit fetar

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit mbi liritë fetare ndërkombëtare* në www.state.gov/j/drl/irf/rpt

d. Liria e lëvizjes

Qeveria ka bashkëpunuar me Zyrën e Komisionarit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR), Organizatën Ndërkombëtare për Migracion (IOM), dhe organizata të tjera humanitare duke ofruar mbrojtje dhe ndihmë për personat e zhvendosur brenda vendit (PZHB), refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit, migrantët, personat pa shtetësi, dhe persona të tjerë në nevojë.

Gjatë vitit, qeveria ka shtuar përpjekjet për t'u marrë me sfidat e migracionit në bashkëpunim me komisionerin e BE-së për migracion dhe çështjet e brendshme dhe ka anoncuar nënshkrimin e një marrëveshjeje për të lejuar vendosjen e ekipeve nga Agjencia e Gardës Kufitare dhe Rojet Bregdetare (FRONTEX) në vend.

Një "gjendje krize" ka qenë në fuqi për zonat kufitare me Greqinë dhe Serbinë që nga gushti i vitit 2015. Çdo gjashtë muaj qeveria e ka zgatur atë deri në fund të vitit. Gjendja e krizës lejon autoritetet qeveritare të rregullojnë hyrjen dhe transitin e migrantëve në vend. Migrantët e kapur në këto zona janë vendosur rregullisht në qendrat e përkohshme të transitit, pranë kufirit, dhe janë kthyer në vendin e mëparshëm të transitit brenda disa ditësh.

Abuzimi i migrantëve, refugjatëve dhe personave pa shtetësi: Sipas Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, që nga shtatori, 2,104 emigrantë janë strehuar përkohësisht në qendrat e vendosura në pikat kufitare veriore dhe jugore me Serbinë dhe Greqinë. Në një raport të prillit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se në vend ka 200 migrantë të vendosur në qendrat e transitit të menaxhuara nga autoritetet qeveritare.

Lëvizja në vend: UNHCR ka vlerësuar se rreth 17,000 persona kanë transituar në vend nga 1 janari deri më 15 gusht, por nuk ka regjistruar ndonjë krim të urrejtjes kundër tyre. UNHCR nuk ka vërejtur ndonjë kufizim të lëvizjes brenda vendit për personat e zhvendosur, refugjatët ose personat pa shtetësi.

Udhëtimi jashtë vendit: Kushtetuta lejon lëvizjen e lirë, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u larguar nga vendi pa kufizime arbitrare, dhe Qeveria mund ta kufizojë vetëm kur është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë kombëtare, hetimet penale, ose shëndetin publik.

Më 9 korrik, policia ka konfiskuar pasaportën e Kryepeshkopit ortodoks të Ohrit Jovan Vranishkovski pa shpjegime ndërsa ai po përpiqej të kalonte kufirin në Greqi. Kryepeshkopata ka akuzuar për "diskriminim karakteristik për vendet ku mungon sundimi i ligjit". Në shtator autoritetet ia kanë kthyer pasaportën, përsëri pa shpjegim. Nuk ka pasur të dhëna për revokimin e shtetësisë gjatë vitit.

Personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV)

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka raportuar se në vend ka 183 persona të zhvendosur, që kanë mbetur në këtë pozitë që nga konflikti i brendshëm i armatosur i vitit 2001, tetë persona (katër familje) kanë jetuar në qendra kolektive të strehimit, dhe 103 persona (23 familje) kanë pasur vendosje private ose në familje pritëse. Qeveria ka ofruar mbrojtje dhe asistencë, dhe ka mbështetur kthimet e sigurta dhe vullnetare, si dhe rivendosjen dhe integrimin lokal të PZHBV-ve. Nuk ka pasur raportime për persona të zhvendosur, viktime të abuzimeve.

Përkundër mungesës së një dokumenti të politikës kombëtare, qeveria përgjithësisht ka respektuar *Paret Udhëzuese të OKB-së për Zhvendosjen e Brendshme*.

Mbrojtja e refugjatëve

Refoulement: UNHCR ka vlerësuar se qasja ndaj azilit është përmirësuar dukshëm që nga viti 2016 dhe se janë zgjidhur shqetësimet e mëparshme lidhur me praktikën arbitrare të refuzimit të azilit. Sidoqoftë, një rast i shkeljes së parimit të non-refoulement ka ndodhur në tetor kur pesë individëve u është mohuar azili.

Qasja në azilit: Ligjet e vendit e parashohin dhënien e azilit ose statusit të refugjatit, ndërkaq Qeveria ka krijuar sistem për dhënien e mbrojtjes për refugjatët. UNHCR ka raportuar se mekanizmi për dhënien e statusit të refugjatëve nuk ka siguruar garanci themelore procedurale dhe përcaktim adekuat, siç parasheh ligji. Ajo ka raportuar se 184 migrantë kishin aplikuar për azil në tetë muajt e parë të vitit. Asnjë person nuk kishte marrë statusin e refugjatit.

Kuadri ligjor parashikon mbrojtje procedurale dhe rishikim. Ka pasur disa konteste lidhur me zbatimin e disa masave mbrojtëse, madje edhe në nivel gjyqësor. Për shembull, megjithëse është e lejuar me ligj, në praktikë gjykatat kanë hedhur poshtë çdo kërkesë për të dëgjuar në apel një aplikues të azilit të pakënaqur.

Në prill parlamenti ka miratuar një Ligj të ri mbi Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme. Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj (SHMAR) ka thënë se ligji i ri adresonte disa nga mangësitë e ligjit të vjetër lidhur me të drejtën e ribashkimit familjar dhe qasjen në azil, por kufizonte padrejtësisht lirinë e lëvizjes së azilkërkuesve. Në maj SHMAR paraqiti një parashtrësë në Gjykatën Kushtetuese duke kundërshtuar nenet 63 dhe 65 të ligjit të ri. IOM ka shprehur shqetësime të ngjashme lidhur me ligjin e ri.

Qeveria u ka lëshuar dokumente të identifikimit të gjithë refugjatëve të njohur dhe personave tjerë nën mbrojtje subsidiare, por autoritetet shpesh i kanë vonuar ose nuk ua kanë lëshuar dokumentet e identifikimit azilkërkuesve të rinj.

Migrantëve në Qendrën e transiti për të huajt iu është mohuar qasja në azil. Një kërkesë për azil nga një person i mbajtur në Qendrën pritëse për të huajt (dmth. Një objekt i mbyllur në Gazi Babë) do të ishte i mundur vetëm pasi personi të jepte një deklaratë para gjykatës, në procedurën penale kundër kontrabandistëve të tij. Gjatë vitit, 55 për qind e të gjitha kërkesave të regjistruar për azil në vend janë përpunuar përmes Qendrës së Pritjes për të Huajt.

Vendi i sigurt i origjinës / transitit: Ligji përmban një përkufizim të gjerë të "vendit të tretë të sigurt" që përfshin çdo shtet anëtar të BE-së, NATO-s ose Zonës së Tregtisë së Lirë të Evropës, me çka në mënyrë efektive përjashton çdo hyrje të migrantëve në vend me vijë tokësore nga vendet e tjera me përjashtim të Kosovës dhe Serbisë për të kërkuar azil.

Liria e lëvizjes: Sipas UNHCR-së, autoritetet kanë ndaluar disa persona të zbuluar gjatë kontrabandimit. Bazat për vendimet e paraburgimit janë arbitrare. Si rregull, personat duhet të mbahen deri në përcaktimin e identitetit të tyre. Megjithatë, ata janë arrestuar në mënyrë rutinore pas identifikimit, për të parandaluar ikjen e tyre nga vendi para se të jepnin dëshmi në gjykatë

kundër trafikantëve. Veç kësaj, shumica e azilkërkuesve të paraburgosur kanë raportuar se nuk janë lëshuar vendime për paraburgim, ose nëse ata kanë marrë vendime të tilla, kjo ka qenë në një gjuhë që nuk mund ta kuptonin, që i pamundësonte të ushtronin të drejtën e tyre për shqyrtim gjyqësor.

Periodha mesatare e paraburgimit në vitin 2018 ka qenë 15 ditë, dhe qëndrimi më i gjatë prej 45 ditë dhe qëndrimi më i shkurtër ka qenë një ditë.

Disa përmirësime janë vërejtur në krahasim me vitet e kaluara, meqë gratë, fëmijët apo familjet në përgjithësi nuk vendosen në paraburgim; në vend të kësaj janë përdorur masa alternative. Një shtëpi e sigurt është marrë me qira për këta persona, me fonde të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale dhe me fonde ndërkombëtare të donatorëve, kështu që ata nuk janë vendosur në burg apo në mjediset e paraburgimit. Megjithatë, kanë qenë nën vëzhgim, dhe janë paraqitur tek autoritetet një herë në javë. Në gjysmën e parë të vitit, UNHCR ka regjistruar 71 persona të mbajtur në paraburgim të emigracionit. Me përjashtim të një fëmije të pashoqëruar dhe të tre grave, të gjithë të paraburgosurit ishin burra të rritur.

Punësimi: Nuk ka kufizime për mundësitë e refugjatëve për të punuar dhe ligji i lejon azil kërkuesit që nuk kanë përfunduar procedurën brenda nëntë muajve, të aplikojnë për leje pune.

Refugjatët e njohur dhe personat nën mbrojtje dytësore me leje pune kanë pasur mundësinë të hyjnë në tregun aktiv të punës. Megjithatë, azilkërkuesit janë përballur me kufizime për shkak të ligjeve kundërshtuese. Sipas ligjit, një i huaj duhet të ketë një numër unik identifikimi të caktuar për t'i lëshuar një leje pune. Megjithëse azilkërkuesi ka të drejtën ligjore të kërkojë leje punë pas nëntë muajsh në procedurë, ai nuk ka të drejtë për numër identifikimi unik, i cili me të njëjtin ligj lëshohet vetëm pas dhënies së një vendimi pozitiv për aplikimin e tij. Si pasojë, azilkërkuesit i jepet e drejta për të punuar, por nuk është në gjendje ta ushtrojë atë, që paraqet një defekt serioz duke marrë parasysh se procedurat mund të zgjasin dy deri në tre vjet, duke përfshirë edhe instancat gjyqësore.

Qasja në Shërbimet Themelore: Azilkërkuesit, para një vendimi përfundimtar mbi aplikimet e azilit, kanë pasur të drejtën e marrjes së shërbimeve themelore shëndetësore, në përputhje me rregulloret për sigurimin shëndetësor. E njëjta gjë vlen edhe për të drejtën e arsimit. Megjithatë, deri më sot, nuk ka pasur raste të fëmijëve që vijnë nga jashtë rajonit, të regjistruar në shkollat publike.

Zgjidhjet e qëndrueshme: Sipas UNHCR-së, asnjë nga 394 individë nga konflikti i vitit 1999 në Kosovë, që kishin mbetur në vend, nuk ishin kthyer në Kosovë, gjatë vitit. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka raportuar se 274 individë kishin shprehur interes për të mbetur. Nuk është regjistruar asnjë rast i zhvendosjes.

Ligji siguron mundësinë për natyralizim për refugjatët që banojnë në vend sipas kushteve të preferuara, ndërsa personat nën mbrojtje plotësuese mund të natyralizohen si çdo i huaj tjetër që qëndron ligjërisht në vend për një minimum prej tetë vitesh. Asnjë refugjat ose person nën mbrojtje plotësuese nuk është natyralizuar gjatë këtij viti.

Sipas ligjit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe UNHCR duhet të mundësojë kthimin vullnetar të azilkërkuesve në shtëpitë e tyre. Nuk ka pasur raste të riatdhesimit të asistuar vullnetar gjatë vitit.

UNHCR edhe më tej i ka ndihmuar azilkërkuesit e refuzuar nga Kosova të cilët qeveria i ka lejuar të qëndrojnë në vend. Qeveria u ka lëshuar dokumente të përkohshme identifikimi, për t'ua siguruar qasjen deri te shërbimet. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka siguruar zgjidhje të integruara dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e UNHCR-së për rreth 274 refugjatë që kanë aplikuar për integrim në vend. Ministria ka siguruar ndihmë sociale, ndihmë për strehim dhe qasje në arsim, shëndetësi dhe në tregun e punës.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria siguron mbrojtjen dytësore për individët të cilët nuk mund të kualifikohen si refugjatë. Dy persona kanë marrë mbrojtje dytësore

Personat pa shtetësi

Disa banorë të përhershëm kanë qenë ligjërisht pa shtetësi, pavarësisht përmbushjes së një ose më shumë kriterëve për shtetësi. Sipas të dhënave të konsoliduara statistikore të Qeverisë, UNHCR-së, dhe OJQ-ve, në vend janë regjistruar 560 persona pa shtetësi, në fund në vitit. Ata kishin qenë kryesisht romë, të cilët nuk kanë qenë të regjistruar dhe kanë qenë pa dokumente të identifikimit. Fëmijët e lindur në vend, nga persona pa shtetësi konsiderohen shtetas dhe kanë të drejtën të regjistrohen dhe të marrin certifikatë.

Rreth 310 persona janë regjistruar si banorë të përhershëm me shtetësi të papërcaktuar dhe në rrezik të pashtetësisë që nga shpërbërja e ish Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë në vitin 1991. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka vlerësuar se rreth 500 fëmijë nuk kishin certifikata lindjeje ose regjistrim të emrit personal në vend. Në fillim të vitit, qeveria ka filluar një program për regjistrimin e personave që nuk kishin dokumente. Ajo ka lëshuar një thirrje publike për personat pa certifikata të lindjes dhe regjistrim të emrit personal për të aplikuar për regjistrimin e lindjes deri në fund të shtatorit.

Ligji parashikon kushte të preferuara për dhënien e shtetësisë për personat pa shtetësi. Për shkak të mungesës së një procedure formale për përcaktimin e pashtetësisë, megjithatë individët nuk mund të përfitojnë nga këto dispozita. Kërkesat janë të vështira dhe procedurat ndryshojnë nga një zyrë lokale e regjistrimit civil në tjetrën dhe nuk kontribuojnë në lehtësimin e procesit të marrjes së shtetësisë, regjistrimit të gjendjes civile ose sigurimit të qasjes në të drejtat.

Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në procesin politik

Ligji iu ofron qytetarëve mundësinë për të zgjedhur qeverinë e tyre në zgjedhje periodike të lira dhe të drejta që mbahen me votë të fshehtë, në zgjedhje të përgjithshëm dhe të barabartë.

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Zgjedhjet e përgjithshme për president u mbajtën në vitin 2014. Sipas raportit të OSBE / ODIHR, administrimi i zgjedhjeve ishte efikas dhe fushata u bë pa pengesa. Raporti gjithashtu ka nxjerrë në pah treguesit e një ndarjeje të papërshtatshme midis aktiviteteve partiake dhe shtetërore, pretendime për frikësimin e votuesve, dhe frikë nga hakmarrja. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 kanë shënuar një rekord pjesëmarrje të lartë dhe janë konstatuar vetëm parregullsi të vogla. Sipas raportit të OSBE / ODIHR-it, edhe pse Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka hasur në vështirësi gjatë përgatitjes për zgjedhjet, dita e zgjedhjeve përgjithësisht është administruar mirë dhe me rregull. Ndërsa ODIHR ka konstatuar se liritë themelore janë respektuar në përgjithësi, dhe kandidatët kanë qenë të gjendje të zhvillojnë lirshëm fushatën, ka vënë në dukje se zgjedhjet janë zhvilluar "në një mjedis të karakterizuar nga mungesa e besimit publik në institucionet dhe establishmentin politik, dhe pretendime për detyrimin e votuesve." Sipas ODIHR, zgjedhjet nuk kanë arritur të përmbushin disa angazhime të rëndësishme të OSBE-së për një proces zgjedhor demokratik, duke përfshirë frikësimin e votuesve, presion i përhapur mbi punonjësit publikë, blerjen e votave, detyrimin, dhe shpërdorimin e burimeve administrative.

Më 30 shtator, u realizua një referendum mbarëkombëtar për marrëveshjen dypalëshe me Greqinë mbi emrin e vendit. Në raportin e tij paraprak, OSBE / ODIHR kishte konstatuar se referendumi është kryer në mënyrë të paanshme dhe liritë themelore janë respektuar. Raporti kanë vënë re se një rregullore e miratuar nga KSHZ-ja që lidhet me referendume kufizonte qytetarët në parashtrimin e ankesave.

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Ka pasur disa kufizime në themelimin ose anëtarësimin në partitë politike, të cilat i janë nënshtruar ligjeve të njëjta si çdo qytetar i zakonshëm. Ndërsa anëtarësimi në një parti politike nuk është i detyrueshëm, ka një sistem aktiv patronazhi në vend ku palët japin përfitime dhe avantazhe të veçanta për anëtarët e tyre. Partia opozitare VMRO-DPMNE ka akuzuar qeverinë për vazhdimin e këtyre praktikave, duke pretenduar se përkatësia partiake është mbivendosur mbi kualifikimet arsimore dhe profesionale të përcaktuara me ligj për pozitën në administratë. Për shembull, më 22 gusht, Sasho Tasevski, ish shefi i Sektorit të sigurisë personale në Ministrinë e Punëve të Brendshme, është emëruar Drejtor i Byrosë së Sigurisë Publike, që mbikëqyr forcat e zbatimit të ligjit të vendit dhe policinë kufitare. Opozita ka kritikuar Tasevskin për mungesë të përvojës menaxhuese.

Pjesëmarrja e grave dhe minoriteteve: Nuk ka ligj që kufizon pjesëmarrjen e grave dhe të minoriteteve në procesin politik, dhe gratë dhe minoritetet kanë marrë pjesë në të. Sipas ligjit, listat e kandidatëve të secilës parti politike për zgjedhjet parlamentare dhe lokale duhet të kenë shumëllojshmëri gjinore. Jo më shumë se dy të tretat e kandidatëve të listës mund t'i takojë gjinisë së njëjtë. Deri në tetor, 46 nga 120 deputetët ishin gra dhe katër gra ishin pjesë e kabinetit qeveritar që numëron 5 ministra. Burrat kanë dominuar vendet udhëheqëse në partitë politike. Nga 208 kandidatët për postet e kryetarit të komunës në zgjedhjet e tetorit të vitit 2017, vetëm 12 ishin gra. Gjashtë gra fituan garën për kryetar komune, katër prej të cilëve kanë qenë në pozitën e njëjtë paraprakisht.

Shqiptarët dhe minoritetet e tjera etnike kanë vazhduar të ankohen për përfaqësimin e pabarabartë në kuadër të qeverisë dhe për praktikën diskriminuese që i përjashtonte ata nga pjesëmarrja politike, siç është lëshimi selektiv i certifikatave të sigurisë. Për shembull, në shkurt, tre shqiptarë etnikë që punonin në aviacionin civil kanë thënë se kishin qenë viktimë e diskriminimit kur DSK ka refuzuar të rinovonte lejet e tyre të sigurisë, pavarësisht se kanë poseduar leje për gati 20 vjet. Si rezultat, këta tre persona kanë humbur vendin e punës. Zëvendësministri i Brendshëm ka deklaruar se DSK-ja nuk ka pasur kritere të përcaktuara qartë për lëshimin e këtyre certifikatave. Nëntë ministra nga 27 në kabinetin qeveritar ishin shqiptarë. Nga 120 deputetët në parlament, 23 ishin shqiptar, duke përfshirë kryetarin e parlamentit.

Pjesa 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në Qeveri

Ligji parasheh ndjekje penale për korrupsion të zyrtarëve, ndonëse ka pasur raporte se zyrtarët e përfshirë në korrupsion nuk janë ndëshkuar. OJQ-të kanë theksuar rolin dominues të qeverisë në ekonomi që ka krijuar mundësitë për korrupsion. Qeveria ka qenë punëdhënësi më i madh në vend, dhe disa analistë kanë vlerësuar se ajo punëson mbi 180.000 persona, pavarësisht se statistikën zyrtare tregojnë se punësimin në sektorin publik është rreth 128,000 persona.

Korrupsioni: Në raportin e tij më 17 prill, EK ka vënë në dukje se kuadri ligjvënës dhe institucional për luftën kundër korrupsionit është vendosur, si dhe evidenca për parandalimin dhe ndjekjen e korrupsionit, megjithëse aktgjykimet në lidhje me rastet e korrupsionit të nivelit të lartë mbeten të limituara. Kapaciteti i institucioneve për të trajtuar në mënyrë efektive korrupsionin ka shfaqur mangësi strukturore dhe operacionale dhe ka pasur raste të ndërhyrjeve politike. Që nga 28 shtator, Zyra e Prokurorisë së Krimit të Organizuar po hetonte më shumë se 100 ish-zyrtarë dhe zyrtarë aktualë për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe pretendime për korrupsion.

Ka pasur raste të shumta të korrupsionit nga zyrtarë të nivelit të lartë gjatë këtij viti. Për shembull, më 1 mars është ngritur hetim penal në lidhje me pretendimet për shpërdorim të fondeve publike nga Komisioni Shtetëror i Antikorrupsionit. Më 6 mars, kryetari i komisionit Igor Tanturovski dhe anëtari Goran Milenkov kanë dhënë dorëheqje. Pas dorëheqjes, Kryeministri Zoran Zaev i ka thënë shtypit se e ka mirëpritur vendimin, duke shtuar se vendi "ka nevojë për një institucion që do të japë shembull dhe do të shërbejë si korrektues i mangësive të sistemit si pjesë e angazhimit të tij për të luftuar korrupsionin". Më 20 shtator, parlamenti nuk kishte emëruar Komision të ri kundër Korrupsionit.

Më 23 maj, Gjykata Penale e Shkupit dënoi ish kryeministrin Nikola Gruevski dhe e dënoi me dy vjet burg në një rast që përfshinte prokurimin shpërdorues të një makine Mercedes Benz të blinduar prej 600,000 eurosh (690,000 euro) në vitin 2012. Më 9 nëntor gjykata hodhi poshtë apelin e tij dhe e urdhëroi të paraqitet në burg ku duhej të vuante dënimin e tij dy vjeçar. Më 12 nëntor, Gruevski ka njoftuar se kishte ikur në Hungari, ku më pas ka marrë azil.

Deri më 15 shtator, Prokuroria Speciale, që hetonte pretendime për korrupsion prej vitit 2008 deri në vitin 2015, kishte 23 gjykime aktive kundër 130 të pandehurve, ka ngritur 168 padi për vepra penale dhe ka hapur shtatë hetime kundër 26 të dyshuarve. Po ashtu ka iniciuar 182 hetime paraprake për sjellje evidente kriminale në lidhje me ose që dalin nga përmbajtja e komunikimeve të përgjuara në mënyrë të paligjshme.

Që nga krijimi i Zyrës së Prokurorisë Speciale në vitin 2015, partia VMRO-DPMNE në pushtet në mënyrë të vazhduar ka penguar punën e zyrës dhe ka kritikuar publikisht Prokuroren Speciale Katica Janeva, duke pretenduar se ajo është e paaftë dhe instrument politik i njëanshëm i partisë LSDM.

Deklarimet financiare: Ligji për anti-korrupsion kërkon që zyrtarët e emëruar dhe të zgjedhur, së bashku me familjet e tyre të afërta, t'i deklarojnë të ardhurat dhe pasurinë, duke paraparë dënime për shkelje të ligjit. Qytetarët kanë pasur mundësi t'i shohin deklaratimet në ueb-faqen e Komisioni Shtetëror Kundër Korrupsionit. Komisioni gjithashtu ka pranuar dhe kontrolluar 1.460 deklaratata të konfliktit të interesit të paraqitura nga zyrtarë publikë.

Pjesa 5. Qëndrimi qeveritar ndaj hetimeve ndërkombëtare dhe joqeveritare për abuzime të pretenduara të të drejtave të njeriut

Grupet vendase dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në përgjithësi kanë vepruar pa kufizime qeveritare dhe i kanë hetuar dhe publikuar gjetjet e tyre mbi të drejtat e njeriut. Zyrtarët qeveritarë kanë bashkëpunuar duke i dëgjuar këto grupe por ngandonjëherë nuk kanë reaguar ndaj vërejtjeve të tyre. Gjatë vitit disa ministri kanë formuar grupe punuese që përfshinin anëtarë të shoqërisë civile, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile u ftuan të merrnin pjesë në debatet parlamentare.

Në vitin 2016 autoritetet tatimore në kohën e qeverisë të mëparshme kanë nisur inspektime në 20 organizata të shoqërisë civile, dhe Zyra e të ardhurave publike synonte OJQ-të që kishin qenë kritike ndaj politikave të qeverisë. Më 1 mars, ministri i brendshëm njoftoi përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile se Ministria e Brendshme kishte kërkuar nga Zyra e Prokurorisë së Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të mbyllë hetimet për shkak të mungesës së provave. Që nga 3 tetori, organizatat nuk kishin marrë njoftim zyrtar lidhur me statusin e hetimit të Zyrës së të Ardhurave Publike.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Avokati i Popullit ka punuar në drejtim të mbrojtjes së qytetarëve nga shkeljet e të drejtave të tyre nga institucionet publike, uljes së diskriminimit ndaj bashkësive pakicë dhe personave me nevoja të posaçme, promovimit të përfaqësimit të barabartë në jetën publike, si dhe trajtimit të të drejtave të fëmijëve.

Qeveria nuk ka siguruar burime të mjaftueshme për zyrën e Avokatit të Popullit dhe të njëjtit nuk ia ka deleguar kontrollin mbi buxhetin e tij.

Komisioni shtatë-anëtarësh për Mbrojtje nga Diskriminimi ka pasur mandat për shqyrtimin e ankesave për diskriminim, dhënien e rekomandimeve dhe promovimin e zbatimit të ligjit antidiskriminim. Komisioni nuk ka pasur kompetencën të ndëshkojë kundërvajtësit. Ndryshe nga Avokati i Popullit, Komisioni i ka shqyrtuar ankesat nga sektori publik dhe ai privat. Qytetarët që nuk janë të kënaqur nga rezultati mund t'u drejtohen gjykatave, të cilat mund ta pranojnë mendimin e shkruar të Komisionit si dëshmi.

Pjesa 6. Diskriminimi, shpërdorimet shoqërore dhe trafikimi me qenie njerëzore

Gratë

Përdhunimi dhe dhuna në familje: Përdhunimi i burrave dhe grave, përfshirë edhe dhuna bashkëshortore është i kundërligjshëm. Dënimet për përdhunim lëvizin prej një deri 5 vite burg, por ka zbatim të dobët të ligjit. Dhuna në familje është e paligjshme, por ka vazhduar të jetë një problem i vazhdueshëm dhe i përhapur.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka regjistruar 620 viktima të dhunës në familje në periudhën janar-qershor, nga të cilat 12 kanë qenë viktima të abuzimit seksual.

Qeveria ka drejtuar shtatë qendra për strehim me kapacitet të kufizuar dhe një OJQ operonte një qendër strehimi me kapacitet prej 30 grave në rrezik. Një OJQ vendase ka operuar me një kontakt-linjë telefonike në maqedonisht dhe shqip, si dhe me dy qendra krize për strehim të përkohshëm të viktimave të dhunës në familje.

Ngacmimi seksual: Ligji e ndalon ngacmimin seksual në vendin e punës dhe jep udhëzime për shqiptimin e dënimit prej tre muaj deri në tre vite burg. Qeveria e ka zbatuar ligjin në mënyrë efektive. Aktivistët e të drejtave të grave kanë formuar një lëvizje të re shoqërore me hashtag #ISpeakUpNow (përkthimi në anglisht) për të treguar normalizimin e ngacmimeve seksuale në shoqëri. Ngacmimi seksual i femrave në vendin e punës ka qenë problem dhe në përgjithësi, viktimat nuk i kanë denoncuar rastet e këtilla për shkak të frikës nga publiciteti dhe humbja e mundshme e vendit të punës.

Detyrim në kontrollin e popullsisë: Nuk ka pasur raportime për abort të detyruar ose sterilizim të pavullnetshëm.

Diskriminimi: Femrat kanë status të njëjtë juridik si edhe meshkujt sipas statusit familjar, fetar, personal, punës, pronës, kombësisë dhe ligjeve të trashëgimisë. Ligjet janë zbatuar në mënyrë efektive. Në disa bashkësi, femrat janë privuar nga e drejta e votës nga ndonjë mashkull i familjes, që e ka udhëzuar votimin ose ka votuar në emër të anëtareve të familjes. Që nga shtatori, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale nuk kishte marrë asnjë ankesë lidhur me trajtimin e pabarabartë të grave në jetën politike.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjes: Ligji e përcakton shtetësinë në radhë të parë sipas shtetësisë së prindërve. Ai gjithashtu parasheh mundësinë që fëmijët e gjetur në territorin e vendit të fitojnë shtetësinë, përderisa autoritetet nuk zbulojnë që prindërit janë të huaj para moshës 18-vjeçare të fëmijës. Të gjitha lindjet në spitale dhe institucione mjekësore janë regjistruar automatikisht dhe ligji kërkon që të gjithë fëmijët të lindur në vend tjetër, përfshirë edhe ata që kanë lindur në shtëpi, të regjistrohen në zyrat e ofiqarit brenda 15 ditëve nga dita e lindjes. Disa familje rome e kanë vonuar regjistrimin e foshnjave të lindura, duke ia vështirësuar atyre qasjen në përfitimet arsimore, mjekësore dhe përfitime tjera në jetë, për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka identifikuar 204 fëmijë që kërkonin regjistrim shtesë personal sepse prindërit nuk kanë pasur një dokument identifikimi të vlefshëm ose për shkak të maternitetit të diskutueshëm për shkak të përdorimit të librezës shëndetësore të një personi tjetër.

Abuzimi i fëmijëve: Ka ligje kundër abuzimit të fëmijëve dhe sanksionet për dënimin përfshijnë gjoba, burgosje dhe mbyllje të bizneseve. Abuzimi i fëmijëve ka qenë problem në disa rajone. Qeveria ka vendosur një linjë telefonike për dhunën në familje, përfshirë edhe abuzimin e fëmijëve.

Martesa e detyruar dhe e hershme: Moshë minimale ligjore për martesë është moshë 18-vjeçare. Gjykata mund ta lejojë martesën për personat e moshës 16-18 vjeçare, në qoftë se konstaton se kanë aftësi mendore dhe fizike për martesë. Martesat e detyruara dhe të hershme kanë ndodhur tek bashkësia rome dhe në masë shumë më të vogël në bashkësinë etnike shqiptare. Nuk ka të dhëna zyrtare statistikore për nëna të mitura.

Eksplotimi seksual i fëmijëve: Ligji ndalon çdo lloj të eksplotimit të fëmijëve për qëllimet e seksit komercial, duke përfshirë ofrimin, shitjen, ose prokurimin e fëmijëve për prostitucion. Dënimet për eksplotimin e fëmijëve për qëllimet e seksit komercial përcaktohen prej 10 deri në 15 vite burg. Ligji e ndalon pornografinë e fëmijëve dhe dënimet për këtë janë prej pesë deri në 15 vite burg. Autoritetet kanë zbatuar ligjin. Moshë minimale për marrëdhënie seksuale me pajtim është moshë 16-vjeçare.

Autoritetet e kanë trajtuar si problem prostitucionin e fëmijëve, por nuk i kanë ditur përmasat. Shteti ka regjistër on-line, ku personat e dënuar për trafikim të fëmijëve dhe keqpërdorim seksual të fëmijëve mund të kërkohen sipas emrit dhe adresës. Aty jepet edhe fotografi, evidenca e dënimit, si dhe adresat e banimit të të dënuarve. Kryerësit e veprës mund të kërkojnë të mënjanohe nga lista 10 vite pas vuajtjes së dënimit, me kusht që të mos e kenë përsëritur veprën.

Fëmijët e zhvendosur: Sipas Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale në qershor ka pasur 78 fëmijë të zhvendosur me prejardhje të ndryshme etnike. Një raport i viti 2016 nga Zyra e Avokatit të Popullit ka vlerësuar se 236 fëmijë jetonin pa strehë. Me mbështetje ndërkombëtare, Ministria ka drejtuar dy qendra ditore për fëmijët e rrugës. Qeveria ka administruar një strehimore transiti për fëmijët e rrugës, por efektiviteti i saj për të siguruar shërbime përkatëse sociale ka qenë i kufizuar si rrjedhojë e sipërfaqes së vogël. (shih pjes;n 2.d.)

Fëmijët e institucionalizuar: Aktivistë dhe Avokati i Popullit kanë raportuar për mungesë të llogaridhënies lidhur me rastet e moskujdesit dhe keqpërdorimit të fëmijëve në jetimore, strehimore dhe qendrat e paraburgimit. OJQ-të dhe UNICEF kanë qenë aktive në këtë fushë.

Në shkurt, Qendra për Punë Sociale-Shkup ka njoftuar Ministrinë e Punës dhe Politikave Sociale për trafikimin e mundshëm dhe shfrytëzimin seksual të një fëmije që mbahet në Institucionin Publik për Kujdesin e Fëmijëve me Probleme Socio-arsimore dhe Sjellje të Çrregulluar. Autoritetet e kanë transferuar fëmijën në Qendrën për Viktimat e Trafikimit të Njerëzve, ku i është dhënë ndihmë. Ministria e Brendshme ka ngritur padi penale kundër shumë personave për trafikimin e fëmijëve. Zyra e Avokatit të Popullit ka regjistruar dy raste të tjera të abuzimit të fëmijëve të institucionalizuar, të dy me prejardhje rome.

Rrëmbimi ndërkombëtar i fëmijëve: Shteti është palë-nënshkruese e Konventës së Hagës për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (1980). Për informata konkrete, vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Shtetit:

<https://travel.state.gov/content/travel/en/International-Parental-Child-Abduction/for-providers/legal-reports-and-data.html>.

Anti-Semitizmi

Sipas bashkësisë hebraike, rreth 200 deri në 250 persona hebrenj banonin në vend. Më 7 mars, policia ka njoftuar se kishin ngritur padi kundër një të dyshuari të mitur për pikturimin e grafitave të svastikës në muzeun përkujtimor të kryengritjes kundër fashizmit, si dhe në disa godina të tjera në qytetin e Prilepit.

Trafikimi me qenie njerëzore

Shikoni *Raportin e Departamentit të Shtetit për trafikimin me qenie njerëzore* në

Personat me nevoja të posaçme

Ligji e ndalon diskriminimin e personave në bazë të aftësive të kufizuara fizike, shqisore, intelektuale dhe mendore, duke përfshirë qasjen e tyre në arsim, punësim, shërbime shëndetësore, informacione, komunikime, ndërtesa, transport, sistem gjyqësor apo shërbime të tjera shtetërore, por qeveria nuk i ka zbatuar gjithmonë këto dispozita në mënyrë efektive. Më 30 tetor, Gjykata Themelore në Gostivar ka urdhëruar paraburgim për tre persona të akuzuar për abuzim të një fëmije 13 vjeçar, i cili thuhet se ka pasur paaftësi intelektuale. Deri më 4 dhjetor, rasti ka qenë ende në fazën e padisë. Ligji parasheh që ata që kanë përjetuar diskriminim të mund të paraqesin ankesë në Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Komisioni është i vendosur në zyrë që ngandonjëherë pa qasje për personat me nevoja të posaçme.

Një fond i veçantë qeveritar për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara rregullohet me ligj të posaçëm. Agjencia e Punësimit e menaxhon fondin, nën mbikëqyrje të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale. Ky fond ka siguruar grante për rindërtimin e zyrave ose për furnizimin me pajisje të zyrave, për të siguruar kushte të arsyeshme për persona me nevoja të veçanta. Sipas ligjit, personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore duhet të marrin aprovim nga komisioni mjekësor i Qeverisë, për të shërbyer në pozita mbikëqyrëse në sektorin privat dhe atë qeveritar.

Ligji kërkon që ndërtesat e reja të ndërtohen sipas standardeve për qasje të lehtë, ndërsa objektet ekzistuese publike duhej ta mundësojnë qasjen për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin 2015. OJQ-të kanë raportuar se godinat publike nuk janë në pajtim me ligjin. Ndonëse të gjithë autobusët e blerë që në vitin 2013 nga Qeveria për Qytetin e Shkupit kanë mundësuar qasje të lehtë, transporti publik, në masë të madhe nuk kanë ofruar akses për personat me aftësi të kufizuara në regjionet e tjera.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka bërë përpjekje për të siguruar mbështetje adekuate për t'ua mundësuar vijimin e rregullt të procesit mësimor fëmijëve me aftësi të kufizuara. Janë punësuar edukatorë të posaçëm, të cilët janë deleguar nëpër shkollat të caktuara ose si edukatorë “të lëvizshëm” në nivel komunal, për t'i mbuluar të gjitha shkollat e komunës, duke i mbështetur mësimdhënësit të cilët kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në klasat me mësim të rregullt. Përveç kësaj, autoritetet shkollore kanë instaluar ashensorë në disa shkollat fillore, si dhe teknologji për t'u ndihmuar nxënësve me aftësi të kufizuara, duke i shfrytëzuar kompjuterët në shkollat e zgjedhura fillore dhe të mesme. Pavarësisht përpjekjeve të cekura, një numër i madh i nxënësve me aftësi të kufizuara edhe më tej mësimin e ndjekin në shkollat të veçanta.

Pakicat kombëtare/racore/etnike

Sipas regjistrimit të vitit 2002, përbërja e popullatës ka qenë: 64.2% maqedonas, 25.2% shqiptarë, 3.9% turq, 2.7% romë, 1.8% serb, 0.8% boshnjakë dhe 0.5% vllleh. Sipas raportit vjetor të Avokatit të Popullit, pakicat etnike, me përjashtim të serbëve dhe vlllehve, kanë pasur përfaqësim më të ulët në shërbimin publik dhe institucionet tjera shtetërore, përfshirë edhe ushtrinë, policinë, agjencitë e zbulimit, si dhe gjykatat, bankën nacionale, doganat dhe ndërmarrjet publike.

Ligji e mundëson arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën maqedonase, shqipe, rome, turke dhe serbe. Numri i nxënësve të pakicave që e kanë vijuar arsimin e mesëm në gjuhën e tyre amtare ka vazhduar të rritet, veçanërisht pas shpalljes së arsimit të mesëm si obligues në vitin 2007, megjithëse Qeveria nuk ka pasur mundësi të sigurojë mësimdhënie të plotë në gjuhën rome, për shkak të mungesës së mësimdhënësve të kualifikuar.

Më 11 janar, parlamenti ka sjell Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve, që shumë shqiptarë etnikë e

kanë parë si zgjidhjen e çështjes së fundit të mbetur nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit. Sjellja e ligjit ka zënë vend të rëndësishëm në negociatat e koalicionit të SDSM me partinë kryesore shqiptare etnike, Bashkimin Demokratik për Integrimin. Deputetët e partisë opozitare VMRO-DPMNE nuk kanë qenë të pranishëm në parlament gjatë votimit dhe kanë lëshuar një deklaratë duke e quajtur ligjin antikushtetues. Presidenti Ivanov nuk ka pranuar të dekretojë ligjin, duke pohuar se ligji është antikushtetues dhe kërcënon sovranitetin, karakterin unitar dhe integritetin territorial të vendit. Megjithëse ligji është sjell dy herë me shumicë votash në Parlament, pa dekretimin e Presidentit ligji ka mbetur i pazabtuar.

Shqiptarët etnikë kanë vazhduar të kritikojnë përfaqësimin e pabarabartë në ministrinë dhe ndërmarrjet publike, si dhe shpërndarjen e pabarabartë të buxhetit. Akademia Policore edhe më tej nuk e ka rekrutuar numrin e mjaftueshëm të aplikuesve për trajnim nga minoritetet që të jetë në pajtim me Kushtetutën, e cila përcakton që administrata të pasqyrojë përbërjen etnike të shtetit. Shqiptarët etnikë kanë pretenduar se Qeveria ka projektuar procesin e testimin në akademinë padrejtësisht duke mohuar qasjen e shqiptarëve dhe minoriteteve të tjera. Në veçanti, shqiptarët etnikë janë ankuar për paragjykimet kulturore në testet. Përfaqësimi etnik i shqiptarëve dhe minoriteteve të tjera brenda stafit civil të Ministrisë së Mbrojtjes ka mbetur i ulët. Disa njësi elite të policisë dhe ushtrisë nuk kanë pothuajse asnjë përfaqësues të minoriteteve etnike.

Romët kanë raportuar diskriminim të gjerë shoqëror. OJQ-të dhe ekspertët ndërkombëtarë kanë raportuar se romëve shpeshherë u është refuzuar punësimi, ndërsa disa romë janë ankuar për mungesë të qasjes deri te fondet për mirëqenie publike. Ministria e Shëndetësisë dhe OJQ Hera, në partneritet me UNICEF, kanë sponsorizuar Programin e Ndërmjetësuesve të Shëndetit të Romëve për të ofruar shërbime të zhvillimit shëndetësor, social dhe të fëmijërisë së hershme në shtatë komuna me numër të madh të popullsisë rome.

Turqit etnikë janë ankuar për përfaqësim të pamjaftueshëm në institucionet shtetërore.

Aktet e dhunës, diskriminimit, dhe abuzime të tjera në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin në bazë të orientimit seksual në fushën e banimit, punësimit, ligjet e shtetësisë, qasjen në shërbimet qeveritare, siç është kujdesi shëndetësor, dhe qeveria i ka zbatuar ligjet e tilla. Marrëdhëniet seksuale midis anëtarëve të të njëjtit seks janë të ligjshme.

Komuniteti lezbik, homoseksual, biseksual, transgjitor dhe interseksual (LGBTI) ka mbetur i margjinalizuar dhe aktivistët që mbështesin të drejtat e LGBTI kanë raportuar incidente të shumta të paragjykitimit shoqëror, duke përfshirë gjuhën e urrejtjes,

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut nuk ka marrë asnjë denoncim për sulme fizike apo dhunë tjetër kundër pjesëtarëve të komunitetit LGBTI. Sipas komisionit, prokurori publik i Shkupit nuk ka qenë efektiv në përpunimin e rasteve të pazgjidhura që përfshinin fjalimin e urrejtjes kundër pjesëtarëve të komunitetit LGBTI. Përveç kësaj, autorët e një sulmi ndaj një qendre LGBTI në vitin 2014 nuk janë kapur.

Si rezultat i ankesave të organizatave LGBTI të vitit 2017 dhe me mbështetjen e Avokatit të Popullit, Ministria e Arsimit ka tërhequr disa tekste shkollorë të cilat janë konsideruar si diskriminuese në bazë të statusit gjinor dhe familjar.

Stigmatizimi shoqëror për HIV dhe AIDS

Ka pasur raporte të izoluara të diskriminimit kundër personave me HIV/AIDS në sektorin e kujdesit shëndetësor.

Pjesa 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e Shoqërimit dhe e drejta për marrëveshje kolektive

Ligji e parasheh të drejtën e themelimit dhe anëtarësimit në sindikata të pavarura, marrëveshje kolektive dhe të drejtën e grevës. Ligji ndalon diskriminimin për aktivitete sindikaliste dhe siguron kthimin në punë të punonjësve të larguar nga puna për këtë arsye. Qeveria nuk ka zbatuar gjithmonë ligjet në fuqi dhe gjobat nuk kanë qenë gjithmonë të mjaftueshme për të penguar shkeljet.

Ligji kërkon që sindikatat e bashkuara të regjistrohen në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe në Regjistrin Qendror të Shtetit. Udhëheqësit e sindikatave kanë raportuar për rastet kur ministria e ka zgjatur procesin e regjistrimit për muaj të tërë pa shpjegim.

Një gjykatë me kompetenca të përgjithshme mund të ndërpresë aktivitetet sindikale me kërkesë të Regjistrimit Qendror ose gjykatës kompetente, kur këto aktivitete konsiderohen të jenë "kundër kushtetutës dhe ligjit." Nuk ka kufizime shtetësie për anëtarësimin në sindikata, ndonëse shtetasit e huaj duhet të kenë leje të vlefshme pune dhe të jenë të punësuar nga kompania ose organi qeveritar i dhënë në lejen.

Qeveria dhe punëdhënësit nuk kanë respektuar gjithmonë lirinë e shoqërimit, të drejtën e grevës dhe të drejtën e Marrëveshjes Kolektive. Sindikatat kanë pohuar se dispozita "përfshijëse" të ligjit ka lejuar punëdhënësit të përjashtojnë deri në 2 për qind të punëtorëve nga negociatat kolektive gjatë grevës. Marrëveshja kolektive lejohet vetëm për sindikatat që përfaqësojnë të paktën 20 për qind të të punësuarve dhe shoqatat e punëdhënësve që përfaqësojnë të paktën 10 për qind të punëdhënësve në nivel në të cilin është lidhur Marrëveshja (kompani, sektori, ose vendi). Mjetet qeveritare të ekzekutimit dhe mjetet juridike kanë qenë të pamjaftueshme. Dënimet për shkelje të ligjit nuk kanë mjaftuar për t'i penguar ato. Procedurat administrative dhe gjyqësore përgjithësisht kanë pësuar vonesa të gjata.

Sindikatat, me përjashtim të disa sindikatave sektoriale, në përgjithësi nuk kanë qenë të pavarura nga ndikimi i zyrtarëve të qeverisë, partive politike, dhe punëdhënësve. Në vitin 2017 nuk ka pasur aktivitete thelbësore sindikale nga asnjë prej dy grupeve më të mëdha sindikale, Federata e Sindikatave të Maqedonisë dhe Konfederata e Sindikatave të Lirë të Maqedonisë. Sindikatat kanë parashtruar ankesa në Zyrën e Avokatit të Popullit kryesisht lidhur me kushtet e pakënaqshme të punës dhe mbrojtjen e pamjaftueshme në vendet e punës për punë me rreziqe për shëndetin ose sigurinë e punonjësve.

b. Ndalimi i punës së detyruar

Kushtetuta dhe ligji i ndalojnë të gjitha format e punës së detyruar, ndërsa Qeveria ka zbatuar në masë të madhe ligjet në fuqi. Ligji parashikon dënim me burg për shkelje në lidhje me punën e detyruar apo për shkatërrimin ose për marrjen e dokumentit të identifikimit, pasaportës apo dokumenteve të tjera të udhëtimit. Ndëshkimet kanë qenë gjithmonë të mjaftueshme për të dekurajuar shkeljet. Ka pasur raste në të cilat gratë dhe fëmijët i janë nënshtruar punës së detyruar, siç është shitja e artikujve të vegjël, në restorante dhe bare. Disa fëmijë romë kanë qenë të detyruar të lypin, shpesh nga të afërmit (shih pjesën 7.c.).

Gjithashtu shih Raportin e Departamentit për Trafikimin me Qeniet Njerëzore
www.state.gov/j/tip/rls/tiprpt/.

c. Ndalimi i punës së fëmijëve dhe mosha minimale për punësim

Qeveria ka vendosur ligje dhe rregullore që lidhen me punën e fëmijëve, duke përfshirë ndalimin e formave më të këqija të punës së fëmijëve. Qeveria ka bërë përpjekje për të zbatuar ligjin në ekonominë formale, por nuk e ka bërë këtë në mënyrë efektive në ekonominë joformale. Në

kuadrin ligjor të vendit për mbrojtjen përkatëse fëmijët nga puna, duke përfshirë format më të këqija të punës së fëmijëve dhe moshën minimale për punë. Moshë minimale për punësim është 15 vjeç, edhe pse fëmijët mund të punojnë si praktikantë ose si pjesëmarrës të programit zyrtar të arsimit profesional. Ligji e ndalon punësimin e të miturve nën moshën 18-vjeçare në vendet e punës që e dëmtojnë shëndetin e tyre psikik ose psikologjik, si dhe moralin. Ai gjithashtu ndalon që të miturit të punojnë natën ose më shumë se 40 orë në javë, por me vetëpunësimin e të miturve ose me punën pa kontratë formale shpeshherë bëhen shkelje të ligjit.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve që e rregullojnë punësimin e fëmijëve. Qeveria ka bërë përpjekje për të zbatuar ligjin në ekonominë formale, por nuk e ka bërë këtë në mënyrë efektive në ekonominë joformale. Policia dhe Ministria, përmes qendrave për punë sociale, janë përgjegjëse për zbatimin e ligjeve mbi trafikimin e fëmijëve duke përfshirë lypjen e detyruar. Ligji parasheh dënim me burg, për personat që janë shpallur fajtorë për blerje, shitje, mbajtje, ose marrje të të miturve me qëllim të shfrytëzimit. Nëse zbatohen, këto dënime do të jenë të mjaftueshme për të parandaluar shkeljet.

Fëmijët në vend, kanë qenë të angazhuar në format më të këqija të punës, duke përfshirë lypjen e detyruar dhe shfrytëzimin seksual me qëllim tregtie. Shembujt më të zakonshëm kanë qenë përdorimi i fëmijëve për të lypur, pastrimin e xhamave të makinave; për mbledhjen e plehrave dhe shitjen e cigareve ose sendeve të tjera të vogla në tregjet e hapura, rrugët, apo në bare dhe restorante të natës. Ndonëse ekzistojnë ligjet e nevojshme në vend, përpjekjet e Qeverisë për eliminimin e keqpërdorimit të punës së fëmijëve kanë qenë kryesisht të paefektshme. Fëmijët e përfshirë në këto aktivitete kanë qenë kryesisht romë, ashkali, dhe egjiptianë të Ballkanit dhe kanë punuar për prindërit e tyre ose familjarët. Zyrtarët shpesh nuk kanë arritur të marrin në përgjegjësi ata që i kanë shfrytëzuar fëmijët, ndërkaq fëmijët romë kanë mbetur të pambrojtur nga shfrytëzimi dhe puna e detyruar.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka financuar dy qendra të kujdesit ditor ku është siguruar edukimi, shërbimet mjekësore dhe psikologjike për fëmijët që detyrohen të lypin në rrugë. Ministria e Punës gjithashtu ka bashkë financuar një qendër të kujdesit ditor që drejtohet nga një OJQ në rrethinën e Shkupit, Shuto Orizarë.

Lexoni edhe *Konstatimet e Departamentit të Punës për format më të këqija të punës së fëmijëve* në www.dol.gov/ilab/reports/child-labor/findings/.

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin ose profesionin

Ligjet dhe rregulloret e punës në përgjithësi e ndalojnë diskriminimin në lidhje me racën, gjininë, aftësitë e kufizuara, orientimin seksual, gjendjen shëndetësore, apo statusin shoqëror. Ligji nuk adreson diskriminimin në bazë të virusit HIV apo ndonjë statusi me ndonjë sëmundjes tjetër ngjyëse. Qeveria jo gjithmonë i ka zbatuar ligjet në mënyrë efektive, dhe ndëshkimet nuk kanë qenë gjithmonë të mjaftueshme për të dekurajuar krimin. Aktivistët civilë janë ankuar se Komisioni Shtetëror për Mbrojtje nga Diskriminimi nuk është duke e bërë punën e tij dhe se shërben thjesht si një qendër punësimi për individët e afërt me partinë e mëparshme në pushtet.

Ka pasur diskriminim në punësim dhe profesion në baza gjinore, në bazë të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të grupeve të caktuara etnike në ushtri, polici, shërbimet e inteligjencës, gjykata, Bankën Kombëtare, në shërbimin doganor, agjencitë shtetërore dhe kompanitë publike dhe private (shih pjesën 6, Minoritete nacionale/racore/etnike). Pavarësisht nga përpjekjet e Qeverisë dhe ndryshimet ligjore për përfshirjen e detyrueshme në arsimin fillor dhe të mesëm, romët kanë vazhduar të jetojnë në grupe të veçuara, pa mbrojtje shëndetësi dhe sociale, kryesisht për mungesë të dokumenteve të regjistrimit. Të dhënat nga Agjencia e Punësimit kanë treguar se për shkak të shkallës së ulët në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin e lartë, romët në përgjithësi e kanë pasur të vështirë të gjejnë punë në ekonominë formale. Pagat e grave kanë mbetur prapa atyre të burrave dhe të pakta kanë qenë gratë në poste drejtuese. Personat me nevoja të posaçme janë ballafaquar me diskriminim në punësim dhe në qasje në vendin e punës.

d. Kushtet e pranueshme të punës

Paga minimale ka qene 12,000 denarë (231 dollarë) në muaj. Deri në qershor, sipas statistikave zyrtare, paga mesatare mujore ka qenë 24,203 (\$ 458) në muaj. Në vitin 2016 Enti Shtetëror i Statistikës ka vlerësuar se 21.9 për qind e popullsisë jetonte në ose nën pragun e varfërisë. Pragu i varfërisë është llogaritur në nivel të një të ardhur mujore prej 14,500 denarë (273 \$) për një familje katër anëtarëshe.

Megjithëse Qeveria ka vendosur standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëdhënësit, këto standarde nuk janë zbatuar në sektorin joformal, të cilat përbëjnë rreth 22 për qind të ekonomisë.

Inspektorët e punës kanë të drejtë të ngrenë padi për kundërvajtje kundër punëdhënësit dhe ta gjobisin ose ta mbyllin ndërmarrjen e tij, deri në korrigjimin e shkeljeve. Numri i përgjithshëm i inspektorëve është vlerësuar si i përshtatshëm për të hetuar shkeljet e ligjit të punës dhe dënimet kanë qenë të mjaftueshme për t'i parandaluar shkeljet. Megjithatë, inspektimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për të siguruar pajtueshmërinë pjesërisht për shkak të një shpërndarje joadekuate rajonale të inspektorëve.

Gjatë vitit, Inspektorati i Punës në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale ka paraqitur padi kundër disa ndërmarrjeve sepse i kanë detyruar punonjësit të punojnë me orar të gjatë pa pushimin e paraparë me ligj, për mospagesë e rrogave, përfitimeve dhe punës jashtë orarit, si dhe për shkurtimin e pushimit të të punësuarve. Shkeljet në lidhje me pagat dhe orarit të shtuar të punës janë konstatuar më shpesh në sektorin e tekstit, ndërtimtarisë, hekurudhave dhe shitjes me pakicë. Zyra e Avokatit të Popullit ka vënë re një numër më të lartë se numri normal i rasteve të ndërprerjes së punësimit në pushtetin lokal për shkak të përkatësisë politike të punonjësit.

Paga minimale, orët e punës, si dhe standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk janë zbatuar në mënyrë efektive. Shumë punëdhënës kanë punësuar duke vepruar në kundërshtim me ligjin, ndërsa bizneset e vogla shpeshherë kanë kërkuar që punonjësit të punojnë përtej orarit të përcaktuar me ligj. Gjatë vitit, Këshilli Kombëtar për Siguri dhe Shëndet nuk ka qenë plotësisht funksional dhe ka pasur vetëm rol këshillëdhënës. Përderisa punëtorët kanë të drejtë ligjore të largohen nga situatat që e rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e tyre pa e rrezikuar punësimin në të ardhmen, punëdhënësit nuk e kanë respektuar gjithmonë këtë të drejtë, siç thuhet për shkak të shkallës së lartë të papunësisë.

Ka pasur mesatarisht 40 viktima në vendin e punës në vit, por pa të dhëna për shkaqet specifike për vdekjet ose lëndimet në vendin e punës.